



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Cn.nr.218/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq anëtarë, në çështjen juridike të paditësit PBC Sh.P.K., me seli në P., kundër të paditurës B. Sh.P.K. me seli në P., lidhur me kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.05.2024, mori këtë,

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të cilës, shkresat e lëndës i dërgohen në procedurë të mëtejshme.

### A r s y e t i m i

Me datën 22.08.2023, pala paditëse, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër palës së paditur, përkitazi me kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes, me të dhënat si në padi dhe petitumin e saj. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e saj C.nr.4787/23 dt.22.12.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së palës paditëse, dhe lënda ti dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, duke vlerësuar se e njëjta ka juridiksion për të vendosur në çështjen konkrete.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KE.nr.251/24 dt.19.04.2024, lidhur me këtë çështje, ka hapur konfliktin e kompetencës midis Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme, të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës bazuar në dispozitën e nenit 25.2 të LPK-së dhe nenin 13.7 të Ligjit Për Gjykatën Komerciale.

Në vështrim të dispozitave të nenit 13, par.1, pika 1.1, pika 1.7 të Ligjit Për Gjykatën Komerciale, parashihet, veç tjerash parashihet se, Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështjet tjera mes tyre, përkatësisht, kontestet mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe duke vendosur përkitazi me konfliktin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë në Prishtinë, në mbështetje të dispozitave të sipër përmendura, si dhe të dispozitave të nenit 12.1 dhe 20 të Ligjit për Gjykatat, nenit 47 të LPK-së, ka gjetur se kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridiko-civile, është Gjykata Themelore në Prishtinë, përveç, tjerash, edhe për faktin se në rastin konkret civil juridik, midis ndërgjyqësve të lartë cekur, nuk kemi të bëjmë me raport afarist a çështje të ndërsjellë tregtare, por, me çështje kontestuese që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes, përkatësisht, si në padinë e paditësit.

Ndaj, nga këtu dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 25.2 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Cn.nr.218/2024 dt.14.05.2024

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha

